REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr: 642/20
Data: Datum: 07/09/2020
PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI KOMUNAL GJILAN

Nr[1] i prokurimit	**651-20-3398-5-2-1**
Nr i brendshëm	**GL 651 20 035 521**

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i tregut dhe parkut në Zhegër**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Bejta Commerce sh.a
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Gllama-Gjilan
(Adresa)

Gjilan — *60000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

+38344677022
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Musë Pireva
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bejtacommerce@gmail.com
(Adresa elektronike)

04.09.2020
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

COMPANY SH.A BEJTA COMMERCE GJILAN

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 03.07.2020 Data e hapjes së ofertave: 24.07.2020 Letra standarde për tenderues të eliminuar: 14.08.2020 Kërkesa për rishqyrtim me dt:17.08.2020 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt:31.08.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me dt. 14.08.2020 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë **Globi- M.I. SH.P.K**, ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i eliminuar.

AK-ja në letrën standarde për tenderues të eliminuar që na ka dërguar neve e ka shënuar se jemi eliminuar për këto arsye: *"Komisioni gjatë vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave duke u bazuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë gjegjësisht te periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë 90 ditë. Në dosjen e ofertuar nga ju komisioni i vlerësimit ka konstatuar se te periudha e vlefshmërisë së tenderit e keni plotësuar për 60 ditë."*

Ju sqarojmë se ne gjatë qasjen në dokumente nuk na është dhënë raporti i vlerësimit, duke e shkelur neni 10 të LPP-së autoriteti kontraktues.

Ju sqarojmë se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë është e pa bazuar, për faktin se në lidhje me periudhën e vlefshmërisë së tenderit ku e kemi plotësuar për 60 ditë dhe jo për 90, ju sqarojmë se ka ndodhur vetëm një lëshim teknik nga ana jonë, ku në vend të numrit 9 është vendosur numri 6. Arsyetimi i AK-së për eliminim është i pa bazuar edhe për faktin se oferta jonë ka validitet akoma andaj lëshimi teknik i bërë nga ana jonë në lidhje me periudhën e vlefshmërisë së tenderit nuk ndikon fare në substancë të këtij aktiviteti të prokurimit dhe në përgjegjshmërinë e ofertës tonë . Andaj duke u bazuar në faktet e lartpërmendura AK-ja ka mundur eventualisht të kërkoj sqarime shtesë në bazë të dispozitave të nenit 59.2 i cili e parasheh qartë se: "*Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues*".

Neni 31.3 i RRUOPP qartë e sqaron, citojmë „*Periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. Periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës*„.

Pra edhe nga kjo dispozitë kuptohet që vlefshmëria është e rëndësishme vetëm në atë periudhë sa të bëhet vlerësimi i ofertave deri te nënshkrimi i kontratës, ndërsa në këtë fazë ku jemi ne oferta jonë është valide, sepse hapja e ofertave është bërë me dt.24.07.2020. Ndërsa sa i përket zgjatjes së validitetit ne e kemi konfirmuar se e zgjasim edhe për 30 ditë tjera, e jemi në gjendje ta zgjasim edhe me shumë nëse është nevojshme. Pra oferta jonë ka qenë valide sa ka zgjatë vlerësimi i ofertave, ndërsa edhe tani ka validitet.

Ky fakt mund të konsiderohet devijim i vogël sipas nenit 59,4 të LPP-së pika (ii) sepse nuk mund të shkaktojë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Devijim i vogël duhet të konstatohet edhe për faktin se ne jemi me çmim më të lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë për **27,079,80 euro,** prandaj nuk duhet lejuar rrezikimin e buxhetit për një devijim jo substancial dhe devijim të papërfillshëm.

Ne gjatë qasjes që kemi pasur në dokumentet e të rekomanduar për kontratë, përveç se ka ofertuar me çmim më të shtrenjtë se ne, ky OE është i papërgjegjshëm me arsyet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë Globi M,I ka ofruar dëshmi për inxhinierin e gjeodezisë z.Izjadin Syla, si kontratën që ne dyshojmë se është falsifikuar nënshkrimi, pasi që i njëjti inxhinier është në marrëdhënie të rregullt pune tek ne, e ku si dëshmi janë listat e ATK-së ku i njëjti inxhinier figuron në këto lista të ATK-së në kuadër të kompanisë tonë. Gjatë komunikimit me inxhinierin në fjalë, i njëjti mohon se ka nënshkruar kontratë me OE e rekomanduar për kontratë dhe se nuk është në dijeni që janë përdor dokumentet e tij, prandaj ky OE është i përgjegjshëm sepse i mungojnë dëshmitë për inxhinierin e gjeodezisë, sepse i njëjti inxhinier është punëtor i rregullt tek kompania jonë. Bashkangjitur keni edhe listat e ATK-së të Bejta Commerce ku figuron emri i inxhinierit të gjeodezisë.

Është e çuditshme se në dosjen e OE të rekomanduar për kontratë gjenden të noterizuara dokumentet për inxhinierin në fjalë nga stafi i Bejta Commerce, pra ne i kemi noterizuar këto dokumente, ndërsa i ka përdor OE i rekomanduar për kontratë. Edhe ky fakt nuk ka mjaftuar për

AK-në që ta eliminojë OE e rekomanduar për kontratë si të papërgjegjshëm.

Në lidhje me këtë inxhinier pas kërkesës për rishqyrtim AK-ja me dt.24.08.2020 na ka kërkuar dëshmitë në lidhje me inxhinierin në fjalë, për të dëshmuar pretendimin tonë se ky inxhinier është në marrëdhënie të rregullt pune tek ne, ndërsa ne me dt.26.08.2020 jemi përgjigjur dhe i kemi dërguar dokumentet shtesë-Listën e punëtoreve nga ATK-ja për vitin 2017, 2018, 2019, 2020 e ku në të gjitha këto vite figuron emri i inxhinierit të gjeodezisë Izjadin Syla si punëtor i rregullt i kompanisë tonë me ç 'rast janë paguar tatimet dhe kontributet nga ana jonë për këtë inxhinier.
Edhe pas këtyre sqarimeve AK-ja nuk ka reflektuar dhe nuk i ka marr për bazë sqarimet dhe dëshmitë që ne i kemi ofruar në lidhje me inxhinierin në fjalë por ka vazhduar aktivitetin e prokurimit si të ishte gjithçka në rregull.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se te makineria tek pika 6-Demolimi i kubëzave ekzistuese dhe skajoreve kjo kompani ka vendosur një kompresor ajri që normalisht nuk është sipas kërkesës së dosjes s ëtenderit sepse është dashur të vendoset eskavator që i demonton anësoret ekzistuese, prandaj duke pasur për bazë edhe këtë dëshmi atëherë rezulton se oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk është në përputhshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj duhet të eliminohet si ofertë e papërgjegjshme.

Ne kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës tonë për rishqyrtim me dt.31.08.2020, mirëpo ky vendim nuk përmban asnjë arsyetim por është vetëm një përshkrim i pretendimeve tona ankimore dhe një qëndrim i tyre pranë arsyes së eliminimit tonë. Ndërsa sa i përket pretendimit tonë në lidhje me dëshmitë e inxhinierit të gjeodezisë Izjadin Syla AK-ja na ka njoftuar se mund ti drejtohemi organeve kompetente për këtë aspekt.
AK-ja edhe në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim nuk ka marr për bazë sqarimet dhe ofrimin e dëshmive që ne i kemi bërë në lidhje me keqpërdorimin dhe përdorimin pa autorizim të dokumenteve të z.Izjadin Syla, i cili inxhinier është në marrëdhënie të rregullt pune tek ne, mirëpo edhe pas këtyre dëshmive, e të cilat dëshmi i ka kërkuar vetë nuk është bindur të ndryshojë mendimin dhe vendimin e tyre në lidhje me OE e rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse e ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë duke e rekomanduar për kontratë edhe pse është i papërgjegjshëm dhe me çmim më të lartë, ndërsa ne jemi OE më i lirë dhe gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha **aspektet përmbajtjesore** të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

OE i rekomanduar për kontratë nuk ka mundur ti ofrojë dëshmitë e kërkesave sipas nenit 64 të LPP-së, ndërsa autoriteti kontraktues nuk ka vepruar sipas nenit 67 paragrafi 2 të LPP-së për ta eliminuar këtë OE sepse nuk ka ofruar prova të mjaftueshme, sipas nenit 69 të këtij ligji për të dëshmuar se është i përgjegjshëm.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse janë të obliguar që të sigurohen që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Prandaj me këtë veprim të AK-së po rrezikohet të dëmtohet buxheti në vlerë prej **27.079.80 €** pa ndonjë arsye konkrete.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e **OE "Bejta Commerce sh.a."** si e bazuar,
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.